

**ANALIZA E
DEPARTAMENTIT JURIDIK, KONTROLLIT TË ZBATIMIT TË STANDARDEVE
DHE ETIKËS PËR VITIN 2016**

Në zbatim të ISSAI 1, Deklarata e Limës, neni 16 i saj ”Raportimi në Parlament dhe ndaj publikut të gjerë”, të ISSAI 12 “Vlerat dhe dobitë e SAI-ve: të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”, Parimi 4 “Raportimi mbi rezultatet e auditimit, duke mundësuar publikun për të mbajtur qeverinë dhe subjektet e sektorit publik të përgjegjshëm”, të ISSAI 20 “Parimet e transparencës dhe të përgjegjshmërisë”, në datën 26.01.2017, në orën 09.30, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, u zhvillua analiza vjetore e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës. Në këtë analizë morën pjesë profesor të Fakultetit Juridik, Dekani i Fakultetit Juridik, Prof. Dr. Artan Hoxha, ish-Dekani i Fakultetit Juridik, Prof. Dr. Skënder Kaçupi, anëtarët e Departamentit Juridik, përfaqësues nga media dhe student të Fakultetit Juridik.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Prof. Dr. Artan Hoxha shprehu vlerësimin për zhvillimin në analizës vjetore të Departamentit Juridik, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë, kjo në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional.

Pas tij fjalën e mori Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, z. Ermal Yzeiraj bëri një përmbledhje të punës së departamentit përgjatë vitit 2016, duke i kushtuar vëmendje çështjeve më sensitive dhe problematikave të evdientuara gjatë ushtrimit të detyrave funksionale. Në fjalën e tij z. Yzeiraj, bëri një përmbledhje të kontrolleve të cilësië (të nxehtë,të ftohtë) kallëzimeve, dhe proceseve gjyqësore me palë KLSH.

Në vijim të analizës u referuan nga a temat si më poshtë:

1. Kontrolli i sigurimit të cilësisë në të nxehtë të dosjeve të auditimit për vitin 2016. (Emiliano Doko)
2. Kontrolli i sigurimit të cilësisë në të ftohtë të dosjeve të auditimit për vitin 2016. (Miranda Haxhia)
3. KLSH në proceset gjyqësore të vitit 2016. (Flavjo Xhuveli).

Në përfundim të analizës u konkludua me objektivat e përmbushur gjatë vitit 2016 dhe me ato të cilat do të duhet të përmbush departamenti për vitin që vjen.